

STATUTI I SHOQËRISË DHE AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në Korçë sot, në datë 09.11.2022, ne themeluesit:

1. **Z. Mikel Ciko**, lindur më 03 Nëntor 1990 me vendlindje Korçë, Korçë dhe identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit me Nr. 034044306 dhe me Nr.J01103073K Id.

Në cilësinë e ortakut themelues të shoqërisë, krijojnë:

Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Eros Shop 2020" Sh.p.k, me me adrese kryesore Lagja Periferike, Rruga Korce - Bilisht, Km 1, Zona Kadastrale 1101, Nr. Pasurie 221/7, Korçë, Shqipëri.

Statuti është akti bazë ku do të mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare " si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

KREU I

NENI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 1.1 Ortakët e vetëm të kësaj shoqërie, janë:
1-Z. Mikel Ciko
i cili zotëron 100 % të kapitalit të kësaj shoqërie.


NENI 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË

2.1. Shoqëria mban emrin "Eros Shop 2020" shpk dhe është person juridik shqiptar.

2.2. Kjo shoqëri e fiton personalitetin e saj juridik, me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.3. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë akt.



NENI 3

SELIA E SHOQËRISË

3.1. Shoqëria “Eros Shop 2020” SHPK ka qendrën në adresën Lagjja Periferike, Rruga Korce - Bilisht, Km 1, Zona Kadastrale 1101, Nr. Pasurie 221/7, Korçë, Shqipëri, dhe ka të drejtë për të hapur degë dhe zyra të përfaqësimit të tjera, në Shqipëri dhe jashtë saj.

3.2. Njësitë strukturore, degët dhe përfaqësitë e saj do të ndërtohen konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me atë të vendeve të tjera ku ajo mund të hapë degë.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

4.1. Qëllimi i shoqërisë është: të kryejë të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë në veçanti:

a) Tregëtim me pakicë dhe shumicë të aksesorëve elektronik dhe mallrave të ngjashme me to.

4.2. Shoqëria mund të hapë gjithashtu zyra dhe degë në çdo vend tjetër në botë ku do ta ketë të mundur, apo të përmbushë të gjitha levizjet tregtare, industriale, financiare, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të nevojshme, ose që konsiderohen të dobishme për arritjen e qëllimit të saj: mund të kontrakttojë kredi dhe financim në përgjithësi, mund të marrë përsipër interesa të tjera, kuota/ aksione, pjesëmarrje në kapitalet e shoqërive të tjera apo dhe kompani të cilat kanë aktivitet tjetër social direkt apo indirekt, pa pasur për qëllim vendosjen tek palët e treta.

4.3. Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga Ortakët e saj.

4.4. Shoqëria mund të zgjerojë ose kufizojë fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

NENI 5

PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE TË SAJ

5.1. Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësisë së ortakëve të saj.

5.2. Ortakët e kësaj shoqërie, nuk janë përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, tej kapitalit themeltar të saj, që ata vetë kanë nënshkruar. Gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakëve të saj.

NENI 6

KOHEZGJATJA

6.1. Shoqëria do të ushtroje aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj.

NENI 7

SIMBOLET E SHOQËRISË

7.1. Shoqëria do të ketë vulën e saj "" Eros Shop 2020" sh.p.k.

KREU II

NENI 8

KAPITALI I SHOQËRISË

8.1. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë "" Eros Shop 2020" Sh.p.k. përbëhet nga para me vlerë të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) lekë, në përputhje me kontributet e ortakëve si më poshtë:

- a) Ortaku Themelues **Mikel Ciko** Zotërues e 1 kuote/pjese me vlerë të përgjithshme 100.000 Lek, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë;

8.2. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

8.3. Kontributi i ortakëve **Mikel Ciko**, i cili është nënshkruar, është 100.000 Lekë (njëqind mijë) Lekë, barabartë me 1 pjesë, sipas pjesëve të përcaktuara në pikën 8.1, e cila përbën 100 % të vlerës së kapitalit.

8.4. Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjesë të veçanta të tij, janë të transferueshme nga ortaku tek të tretët. Transferimi i kapitalit apo pjesëve të tij nga Ortaku në favor të të tretëve, kryhet gjithnjë me akt juridik të posaçëm.



9.2. Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin themeltar ose mund ta zvogelojë atë, por në çdo rast jo nën kufirin e përcaktuar ligjor. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit behet me vendim të ortakëve të shoqërisë dhe sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

9.3. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

9.5. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

NENI 10

TRANSFERIMI I KUOTAVE

10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

10.3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

10.4. Kalimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së tyre, nga ortakët e tjerë të shoqërisë.

KREU III

NENI 11

ORGANI VENDIMMARRËS



11.1. Asambleja e kësaj shoqërie është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

11.2. Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme, për të qenë i vlefshëm, duhet të miratohet me tre të katërtat (3/4) e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës.

11.3. Asambleja vendos për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

11.4. Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët e saj duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit, nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Në regjistrin e vendimeve, duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.5. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

11.6. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 12

MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

12.1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e

asamblesë.

12.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 12.1., të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parrregullsisë.

NENI 13

KUORUMI

13.1. Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme duhet të jetë me shumicë të kualifikuar, me tre të katërtat (3/4) e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës.

NENI 14

ADMINISTRATORI

14.1. Administratori i shoqërisë është: Mikel Ciko identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit me Nr. J0110373K. Me një afat emerërimi prej 5 vjetësh, me të drejtë ripërtëritje.

14.2. Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

14.3. Administratori i shoqërisë mund të caktohet edhe një person tjetër, jashtë ortakut.

NENI 13

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të shoqërisë.
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç

parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

13.2. Administratori është i detyruar të thërrase mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

13.3. Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

13.4. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji i'a jep shprehimisht ortakëve.

13.5. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

NENI 14

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

NENI 15

BILANCI I SHOQËRISË DHE DIVIDENTET

15.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët e shoqërisë miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.



15.2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

NENI 16

MBARIMI I SHOQËRISË

16.1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
- d) me vendim të gjykatës;

16.2. Në këtë rast ortakët e shoqërisë marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të shoqërisë emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

16.3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

16.4. Nëse ortakët e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 17

TRANSFORMIMI I SHOQËRISË

17.1. Transformimi i shoqërisë bëhet me vendim të ortakeve të shoqërisë ose kur ekzistojnë faktorë të jashtëm detyrues ligjor. Në këto raste vendimi merret pasi administratori të ketë paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë.

17.2. Çdo transformim i bërë në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.

NENI 18

BAZA LIGJORE

18.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



18.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

NENI 19 MOSMARRËVESHJET

19.1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

19.2. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë.

NENI 20 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

20.1. Ky statut është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të ortakëve të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre.

20.2. Ky Statut u redaktua në gjashtë kopje, në gjuhën shqipe, me vlere të njëjtë juridike. Një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "Eros Shop 2020" SH.P.K.

1- Mikel Ciko

